



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 5/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 674/6 Prot.

Tiranë, më 30.12.2016

V E N D I M
Nr. 172, datë 30.12.2016

*“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit,
filluar me Urdhrin nr. 674/1 prot., datë 25.11.2016”*

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1 dhe nenet 14 e 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në përfundim të procedurës së verifikimit,

VËREJ SE :

Me anën e një kërkesë nr. 674 prot., datë 22.11.2016, drejtuar Komisionerit, nëpunësi ***** me detyrë “Drejtore në Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimit”, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, pretendon se për shkak të një mosmarrëveshje me titullarin e institucionit, që në këtë rast është dhe eprori i tij direkt, ka lindur një debat i zhvilluar në zyrën e nëpunësit në fjalë, e për pasojë si ndëshkim eprori i tij ka kryer veprimet për të nisur tre ecuri disiplinore të njëpasnjëshme kundër tij, e fundit nga të cilat ka përfunduar me dhënien e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, nga Komisioni Disiplinorë i ngritur për të shqyrtuar këtë rast.

Për arsye se, nga kërkesa në fjalë lindin dyshime të arsyeshme për cenimin e të drejtave të nëpunësit civil që garantohen nga legjislacioni për shërbimin civil Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me Urdhrin nr. 674/1 prot., datë 25.11.2016, filloi procesin e verifikimit të ligjshmërisë për këtë rast.

Nga aktet e administruara dërguar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit me aktin nr. 674/1, datë 13.12.2016, ka rezultuar se, nëpunësi ***** ka filluar marrëdhënien e punës me aktin e emërimit nr. 321, datë 24.02.2014, të Drejtorit të Përgjithshëm, në pozicionin “Drejtore në

Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimit”, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Fillimi i efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, e gjeti këtë punonjës në këtë pozicion pune për një periudhë më pak se një vit, prandaj njësia përgjegjëse (DAP), me të drejtë me aktin nr. 2135/34, datë 15.08.2014, e deklaroi si “*nëpunës civil në periudhë prove*” në atë pozicion. Në përfundim të periudhës një vjeçare të provës, Drejtori i Përgjithshëm, në cilësinë e eprorit direkt, me aktin administrativ nr. 199/1, datë 10.06.2015, ka vendosur ta konfirmojë si “*nëpunës civil*”, në pozicionin “*Drejtor në Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimit*”.

Instituti i disiplinës në shërbimin civil rregullohet në mënyrë të hollësishme në Kreun X, “*Disiplina në shërbimin civil*”, nga nenet 57 deri 61, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar. Në këtë kapitull përcaktohen në mënyrë specifike përgjegjësia për masat disiplinore, llojet e masave disiplinore; kompetencat dhe procedura për masat disiplinore; parimet për përshkallëzimin dhe individualizimin e masës disiplinore dhe shuarja e masës disiplinore.

Në zbatim të këtyre dispozitave, në Vendimin nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil*” si dhe në udhëzimin nr. 1, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për elementët kryesore procedurale dhe materiale të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore*”, janë përcaktuar procedurat e hollësishme dhe të gjitha masat që duhet të ndërmerren nga personat kompetentë për dhënien dhe zbatimin e tyre.

Në kuadër të këtij verifikimi, pas këqyrjes së dokumentacionit të vënë në dispozicion, në lidhje me praktikat e ecurive disiplinore që janë aplikuar kundër nëpunësit ******, Komisioneri ka trajtuar dhe analizuar hollësisht në mënyrë individuale të tre rastet, në vijim:

➤ *Procedura disiplinore nisur me aktin nr. 4394/1, datë 25.10.2016, “Njoftim mbi fillimin e procedimit disiplinor për shkelje të rënda”.*

Drejtori i Përgjithshëm, ka arritur në përfundimin se nëpunësi ******, ka kryer disa shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të detyrës, të cilat konsistojnë në sjellje të parregullt në mënyrë të përsëritur, me eprorin, të cilat cenojnë figurën e nëpunësit civil dhe institucionit në tërësi. Për këtë arsye, me cilësinë e eprorit direkt i ka klasifikuar ato si shkelje të rënda dhe nisur nga përmbajtja e nenit 59, pika 2, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, me shkresën nr. 4394, datë 25.10.2016, për efekt kompetence, ia ka përcjell informacionin Komisionit Disiplinor, i cili është ngritur me aktin nr. 4394/1, datë 25.10.2016.

Në bazë të kësaj kërkesë, Komisioni Disiplinor ka nisur një procedim administrativ dhe me aktin nr. 4394/3, datë 25.10.2016, ka njoftuar nëpunësin të cilit i atribuohet shkelja, duke i garantuar të drejtat që parashikohen në pikën 7, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, të tilla si e drejta për t’u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit; e drejta për t’u njohur lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj; e drejta për t’u dëgjuar, për të paraqitur prova, për mbrojtje juridike dhe e drejta për t’u asistuar nga një avokat apo një përfaqësues ligjor.

Sipas aktit të njoftimit, seanca dëgjimore për shqyrtimin e ecurisë disiplinore është caktuar të zhvillohej në datën 31.10.2016. Ndërkohë, pa u mbledhur akoma Komisioni Disiplinor dhe pa pritur konkluzionin e tij, Drejtori i Përgjithshëm me aktin nr. 4430, datë 27.10.2016, ka urdhëruar pezullimin nga detyra për nëpunësin ******, deri në momentin e marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionit Disiplinor.

Në referencë të pikës 6, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Komisioni Disiplinor, mund të vendosë pezullimin nga detyra të nëpunësit civil, nëse ka arsye të besohet se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga nëpunësi civil, ndaj të cilit ka filluar një procedim disiplinor, pengon hetimin administrativ apo mund të cenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij. Në këtë rast, konstatojmë se urdhri i mësipërm për pezullimin e nëpunësit ******, është në kundërshtim me dispozitën e mësipërme, për arsye se është nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm në kapërcim të kompetencave dhe jo nga Komisioni Disiplinor, në cilësinë e organit kompetent.

Nisur nga sa analizuam më sipër, urdhri nr. 4430, datë 27.10.2016, në bazë të germës “a/i”, të nenit 108, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, është akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, për arsye se vjen në kundërshtim të hapur me nenin 59/6, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, lidhur me organin kompetent për nxjerrjen e tij dhe bazuar në nenin 110, të ligjit në fjalë, ky akt nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë duke u konsideruar sikur nuk ekziston.

Më tej, seanca dëgjimore është zhvilluar në datën 01.11.2016, përmbajtja e të cilës pasqyrohet në procesverbalin nr. 4394/4, datë 01.11.2016, të Sekretariatit Teknik ngritur për të asistuar Komisionin. Sipas përmbajtjes të këtij procesverbali në këtë seancë morën pjesë të gjithë anëtarët e Komisionit Disiplinor dhe nëpunësi ****** në prani të përfaqësuesit të tij ligjor, i cili ka paraqitur observacionet e tij në lidhje me shkeljen e pretenduar.

Pas analizës së shkeljes së pretenduar, Komisioni Disiplinor, ka konkluduar se shkeljet që i atribuohen nëpunësit ******, nuk janë klasifikuar drejtë dhe nuk janë në juridiksionin lëndor të komisionit Disiplinor. Konkretisht Komisioni në arsyetimin e tij ka konstatuar se nëpunësi në fjalë nuk ka kryer sjellje të parregullt në mënyrë të përsëritur gjatë orarit të punës me eprorin direkt dhe nuk ka kryer në mënyrë të përsëritur veprime që cenojnë figurën e nëpunësit civil dhe institucionit në tërësi. Këtë konkluzion Komisioni e ka bazuar edhe në faktin se ndaj nëpunësit ****** nuk ishte marrë më parë ndonjë masë disiplinore.

Në përfundim të këtij procesi administrativ, Komisioni i Disiplinës, me vendimin nr. 4394/5, datë 01.11.2016, bazuar në pikën 12 të Kreut II, të Vendimit nr. 115 dt. 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”, vendosi të dërgojë çështjen pranë eprorit direkt të nëpunësit, për arsye se nga hetimi administrativ rezultoi se shkelja që i atribuohet nëpunësit nuk është klasifikuar drejt nga Drejtori i Përgjithshëm, dhe nuk është në juridiksionin lëndor të organit disiplinor që e ka marrë në shqyrtim kërkesën.

➤ *Procedura disiplinore nisur me aktin nr. 4394/7, datë 25.10.2016, “Njoftim mbi fillimin e procedimit disiplinor për shkelje të lehtë”.*

Pas daljes së vendimit nr. 4394/5, datë 01.11.2016, të Komisionit të Disiplinës, për kalimin për kompetencë të ecurisë disiplinore pranë eprorit direkt të nëpunësit ***** , Drejtori i Përgjithshëm me aktin nr. 4394/6, datë 04.11.2016, ka filluar edhe një herë procedimin administrativ, këtë herë për shkelje të lehtë disiplinore.

Për fillimin e këtij procedimi disiplinor, nëpunësi në fjalë është njoftuar me aktin nr. 4394/7, datë 04.11.2016, në mënyrë që të njihet me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, për të pasur mundësinë për t'u dëgjuar, për të paraqitur prova dhe për mbrojtje juridike. Seanca dëgjimore ashtu siç ishte përcaktuar në aktin e njoftimit, siç del nga përmbajtja e procesverbalit nr. 4394/8, është çelur në datën 11.11.2016, në mungesë të nëpunësit të proceduar.

Meqenëse, punonjësi i proceduar nuk është paraqitur, eprori direkt, në cilësinë e organit disiplinor, bazuar në pikën B, "*Zhvillimi i seancës për shqyrtimin e procedimit disiplinor*", të Udhëzimit nr. 1, datë 02.04.2014, "*Elementet kryesore procedurale dhe materiale te ecurisë dhe shqyrtimit te shkeljeve disiplinore*", të Departamentit të Administratës Publike, ka vendosur shtyrjen e seancës disiplinore, për në datën 14.11.2016, për të cilën ka njoftuar nëpunësin e proceduar me aktin nr. 4394/9, datë 11.11.2016.

Në vazhdim edhe në seancën e datës 14.11.2016, nga organi disiplinor u konstatua mosparaqitja e nëpunësit apo përfaqësuesit të tij ligjor. Në këtë rast, eprori direkt mbështetur në paragrafin e dytë të pikës B, "*Zhvillimi i seancës për shqyrtimin e procedimit disiplinor*", të Udhëzimit nr. 1, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, si dhe për arsye se nëpunësi i proceduar nuk u paraqit dy herë radhazi në seancën dëgjimore, pa parashtruar ndonjë shkak të arsyeshëm për mosprezencën e tij, vendosi vazhdimin e ecurisë disiplinore në mungesë.

Nga verifikimi i dokumentacionit që materializon këtë procedurë, rezulton se nuk del e provuar që nëpunësi ***** të jetë njoftuar në një prej formave të njoftimit që parashikohen në Kodin e Procedurave Administrative.

Në përfundim, eprori direkt me vendimin nr. 4394/11, datë 14.11.2016, ka vendosur dhënien e masës disiplinore "*Vërejtje*", ndaj nëpunësit *****.

Nga hetimi administrativ në këtë procedurë rezultojnë disa parregullsi administrative të cilat i rendisim më poshtë:

Së pari, njoftimet për fillimin e kësaj ecurie disiplinore janë në formë shkresore të protokolluara pranë institucionit, ndërkohë nuk ka dokumentacion, prova ose fakte që vërtetojnë marrjen në dijeni nga nëpunësi i proceduar.

Së dyti, që në fillim të këtij procedimi disiplinor për shkelje të lehtë, e deri në mbarimin e tij, nëpunësi i proceduar ka qenë i pezulluar si pasojë e aktit nr. 4430, datë 27.10.2016, të Drejtorit të Përgjithshëm, e për këtë shkak nuk ka qenë i pranishëm në ambientet e punës. Duke mos qenë i pranishëm në ambientet e punës nëpunësi nuk ka pasur mundësi të njoftohet personalisht në mënyrë të drejtpërdrejtë për fillimin e ecurisë disiplinore për shkelje të lehtë, sikurse edhe për njoftimin e dytë për shtyrjen e saj.

Së treti, rezulton se njëkohësisht ndaj këtij nëpunësi, ka filluar edhe një procedurë tjetër disiplinore për shkelje shumë të rëndë (*e cila është trajtuar hollësisht më poshtë*) paralelisht me procedurën në fjalë. Nga hetimi administrativ rezulton se ekzistojnë dy njoftime, përkatësisht njoftimi nr. 4394/7, datë 04.11.2016, “*Njoftim mbi fillimin e procedimit disiplinor për shkelje të lehtë*” dhe njoftimi nr. 4547/2, datë 04.11.2016, “*Njoftim mbi fillimin e procedimit disiplinor për shkelje shumë të rëndë*”. Nga përmbajtja e të dy njoftimeve, rezulton se nëpunësi është thirrur në të njëjtën datë 11.11.2016, për të marrë pjesë në dy seanca të ndryshme dëgjimore, si pasojë e dy procedurave të ndryshme disiplinore. Të gjitha këto veprime tregojnë për elementë të një pozicionimi të eprorit ndaj vartësit, në kundërshtim me parimin e dhënies së ndihmës aktive, mirëbesimit, objektivitetit, ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit, etj.

Së katërti, rezulton se shkeljet e prezumuara se janë kryer prej nëpunësit *****, që janë shqyrtuar në ecurinë disiplinore të filluar me aktin nr. 4394/7, datë 04.11.2016, “*Njoftim mbi fillimin e procedimit disiplinor për shkelje të lehtë*”, janë paraqitur për shqyrtim mes shkeljeve të tjera edhe në ecurinë disiplinore të filluar me aktin nr. 4547/2, datë 04.11.2016, “*Njoftim mbi fillimin e procedimit disiplinor për shkelje shumë të rëndë*”.

Nisur nga gjithë sa u analizua më sipër arrimë në konkluzionin se, nga administrimi i akteve të dërguara nga institucioni për këtë procedurë disiplinore nuk arrihet të vërtetohet, nëse nëpunësi kishte dijeni për njoftimin nr. 4394/7, datë 04.11.2016, “*Njoftim mbi fillimin e procedimit disiplinor për shkelje të lehtë*”, ç’ka në vështrim të pikës “b” të nenit 109 të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, vlerësohet si element i paligjshmërisë së veprimit administrativ.

➤ *Procedura disiplinore nisur me aktin nr. 4547/2, datë 04.11.2016, “Njoftim mbi fillimin e procedimit disiplinor për shkelje shumë të rëndë”*

Ashtu si sqaruam dhe më sipër, pa përfunduar procedura disiplinore, për shkelje të lehtë, e përcjellë tek eprori direkt nga Komisioni i Disiplinës, ka nisur një procedim tjetër disiplinor kundër të njëjtit punonjës, në të cilin janë parashtruar disa shkelje të pretenduara se janë kryer prej tij, të klasifikuara nga eprori i tij direkt, si shkelje shumë të rënda.

Kjo ecuri disiplinore ka nisur nëpërmjet aktit nr. 4547, datë 04.11.2016, të Drejtorit të Përgjithshëm, dhe çështja i është dërguar për kompetencë Komisionit Disiplinor, i cili është ngritur me urdhrin nr. 4547/1, datë 04.11.2016, të drejtuesit të institucionit.

Pas shqyrtimit të kërkesës në fjalë Komisioni Disiplinor, me aktin nr. 4547/2, datë 04.11.2016, i cili njëkohësisht është dhe akti për fillimin e procedimit disiplinor, ka njoftuar nëpunësin *****, se ndaj tij ka filluar një ecuri disiplinore, për shkelje shumë të rëndë.

Seanca e shqyrtimit të kësaj ecurie disiplinore është mbajtur në datën 17.11.2016 (*pas disa shtyrjesh për shkaqe të arsyeshme*), brenda ambienteve të Drejtorisë të Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

Në këtë seancë, Sekretariati Teknik ngritur për të asistuar Komisionin Disiplinor ka mbajtur një procesverbal (*nr. 4547/8, datë 17.11.2016*) në të cilin janë përshkruar gjithë aspektet e trajtuara në seancë. Nga përmbajtja e këtij procesverbali rezulton se në seancë kanë marrë pjesë të gjithë

anëtarët e Komisionit Disiplinor, *(duke përfshirë dhe eprorin direkt, si relator i çështjes për shkak të ligjit)* dhe nëpunësi i proceduar *****, bashkë me përfaqësuesin e tij ligjor. Në përfundim Komisioni Disiplinor, me vendimin nr. 4547/11, datë 18.11.2016, ka vendosur dhënien e masës disiplinore *“Largim nga shërbimi civil”*, për punonjësin *****. Në mbështetje të këtij vendimi, me aktin nr. 4547/12, Drejtori i Përgjithshëm ka urdhëruar ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe asaj financiare.

Nga përmbajtja e dokumentacionit që materializon këtë procedurë rezulton se, Komisioni Disiplinor ka pranuar se nëpunësi ***** ka kryer disa shkelje disiplinore, në lidhje me mospërbushjen e detyrave, mosrespektimin e përsëritur të afateve të caktuara në përbushjen e detyrave, moszbatimin haptazi të dispozitave ligjore për përbushjen e detyrave funksionale, shkelje të përsëritur të rregullave të etikës, etj.

Për të argumentuar qëndrimin e tij, Komisioni ka pranuar ndërmjet të tjerave, si prova materiale disa konkluzione të shkëputura, nga Raporti Përfundimtar i realizuar nga Sektori i Auditit të Brendshëm nëpërmjet aktit të këtij të fundit nr. 124/6 dt. 28.06.2016 *“Për përfundimin e angazhimit të auditimit”*.

Më konkretisht bëhet fjalë, për një auditim nisur me urdhrin nr. 723, datë 24.02.2016, të Drejtorit të Përgjithshëm, me temë *“Vlerësimi i kontrolleve të brendshme dhe procedurave që ndiqen, për rastet e njoftimeve të dhënë nga sistemi RASFF”*, për periudhën nga datën 01.01.2015, deri në datën 29.02.2016, proces i cili ka filluar në datën 25.02.2016 dhe ka përfunduar në datën 05.03.2016.

Nga verifikimi i përmbajtjes së Raportit Përfundimtar dërguar AKU-së me shkresën nr. 124/5, datë 06.04.2015 dhe shkresën nr. 124/6, datë 28.06.2016, *“Për përfundimin e Angazhimit të Auditit”*, rezulton se audituesit (***** dhe *****), në përfundim të procesit të auditimit kanë arritur në konkluzionin se: *“Sistemi RASFF funksionon, por në disa hallka të rëndësishme të tij, paraqitet me mangësi si nga pikëpamja procedurale por edhe nga pikëpamja menaxheriale”*, në vijim përshkruan drejtimet kryesore që duhen përmirësuar nga institucioni *(shiko shkresën nr. 124/6, datë 28.06.2016)*.

Në lidhje me konkluzionet e arritura, audituesit ngarkojnë me përgjegjësi jo vetëm Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektiveve *(këtë të fundit e drejtonte nëpunësi i proceduar)*, por edhe Drejtorinë e Vlerësimit dhe Komunikimit të Riskut. Grupi i auditimit ka konkluduar gjithashtu se Rregullorja e Brendshme miratuar me urdhrin nr. 385, datë 13.09.2011, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU, ka nevojë urgjente për përmirësim në lidhje me afatet që duhen ndjekur për menaxhimin e sistemit RASFF dhe në përcaktimin e strukturave përgjegjëse për ndjekjen e rasteve të paraqitura, përmirësime të cilat duhet të pasqyrohen në mënyrë të detajuar në rregulloren e re.

Duke shqyrtuar përmbajtjen e Raportit të Auditimit, konstatohet se në shumicën e rasteve bëhet fjalë për shkelje të ndryshme, të karakterit praktik, për mospasqyrim të plotë të veprimeve të përditshme gjatë aktivitetit të inspektorëve; për boshllëqe në plotësimin e detyrave nga ana e nëpunësve të terrenit; për mosndjekje ose mospasqyrim të plotë të gjithë aktivitetit në ndjekje të denoncimeve të RASFF, etj., por në asnjë rast nuk përmendet ose vishet me përgjegjësi

disiplinore në mënyrë individuale Drejtori i Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektorëve, nëpunësi *****.

Në 12 rastet e përshkruara nga grupi i auditimit, që lidhen me aplikimin e sistemit RASFF, tregojnë se në të gjitha rastet ka reagim nga strukturat e Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimeve, por për raste të ndryshme janë konstatuar mangësi të ndryshme, të cilat kanë të bëjnë me aspekte të veçanta të zbatimit të rregullores, të cilat lidhen dhe me disa mangësi të kësaj të fundit.

Nga gjithë sa analizuam më sipër, rezulton se mosrealizimet, kalimi i afateve, mosndjekja e problemit deri në përmbylljen e plotë të tij, etj., (*gjithmonë, bëhet fjalë për 12 rastet e RASFF, që i janë nënshtruar auditimit*) janë shkelje që janë kryer nga inspektorët e terrenit dhe nuk janë veprime direkte të nëpunësit *****.

Në rastin konkret, përgjegjësia e këtij nëpunësi, qoftë për sa u tha më lart, qoftë dhe për natyrën drejtuese dhe menaxhuese të pozicionit të tij, është e natyrës së përgjegjesisë indirekte.

Një nëpunës me natyrë drejtuese, mund të mbajë përgjegjësi indirekte, kur vërtetohet se nga moskryerja si duhet e veprimtarisë së tij drejtuese e kontrolluese, vartësit kanë kryer shkelje të rënda të disiplinës formale apo disiplinës në punë dhe nga kjo kanë ardhur pasoja të shumë të rënda. Në rastin konkret, për asnjë prej vartësve të nëpunësit ***** , nuk rezulton të jetë zhvilluar ndonjë ecuri disiplinore apo të jetë marrë ndonjë masë disiplinore, prandaj procedimi disiplinor duket në shkelje të parimit të proporcionalitetit (*neni 12 i ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i RSH"*)

Ishte detyrë e institucionit (*që në këtë rast përfaqësohet nga Drejtorit i Përgjithshëm, i cili paraqitet edhe si epror direkt*) të vërtetonte para Komisionit të Disiplinës, cilat janë dëmet që kanë ardhur nga ato shkelje të pretenduara se janë kryer prej nëpunësit *****; cila është natyra e tyre dhe cila është shkalla e dëmit të ardhur veprimtarisë së institucionit.

Veç sa më sipër, në zhvillimin e këtij procesi administrativ konstatohet një element tjetër paligjshmërie; konkretisht, në raportin e auditimit, ngrihen probleme të të njëjtës natyrë, si për Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimeve (*ku drejtues ishte ******) ashtu dhe për Drejtorinë e Vlerësimit dhe Komunikimit të Riskut, por ndërsa për të parin është marrë masa disiplinore ekstreme, për të dytin nuk ka fare ecuri disiplinore.

Kjo vjen në kundërshtim më parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, parashikuar nga neni 17, i ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*" në të cilin kërkohet shprehimisht që, për raste që janë në situata të njëjta objektive, trajtohen në të njëjtën mënyrë. Edhe kjo është një tregues tjetër subjektivizmi, i cili cenon ushtrimin e ligjshëm të diskrecionit, nga ana e eprorit direkt (*neni 11, i ligjit në fjalë*).

Mosplotësimi i këtyre kushteve, passjell subjektivizëm dhe elementë paligjshmërie në marrjen e vendimit për largimin nga shërbimi civil, në rastin konkret.

Edhe disa rrethana të tjera, si koha e shkurtër e punës së eprorit me vartësin, koha e kaluar nga dita e përfundimit të procesit të auditimit, zhvillimi i disa ecurive disiplinore, njëra pas tjetrës,

brenda pak ditëve, flet për subjektivizëm në ndjekjen e problemit dhe elemente të tjerë paligjshmërie.

Bazuar në pikën 4/c, të Kreut II, të Vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”, ankesa, kërkesa apo rekomandimi në lidhje me shkeljen disiplinore të pretenduar nga eprori direkt i nëpunësit për të cilin pretendohet se ka kryer shkeljen, nëpunësit e institucionit apo çdo organi tjetër publik, ose njësi me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo audit, duhet të plotësojë mes të tjera dhe kushtin që konsiston në përcaktimin e veprimit konkret, që pretendohet se përbën shkelje disiplinore dhe rrethanat e kryerjes së tij dhe nuk mund të pranohet që të ngarkohet një nëpunës civil, me përgjegjësi në mënyrë gjenerike, pa përcaktuar veprimin konkret që përbën shkelje dhe vërtetimin e pasojës së ardhur prej saj.

Vetëm në këtë mënyrë, organizmi që shqyrton një mosmarrëveshje disiplinore, mund të përcaktojë masën disiplinore të zbatueshme sipas rastit, duke u bazuar në shkallën e fajësisë dhe shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e ardhura prej saj, në përputhje me parimin e përshkallëzimit dhe individualizimit të masës disiplinore sipas përcaktimeve të nenit 60, të ligjit nr. 152/2015, “Për Nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Bazuar nga gjithë sa analizuam më sipër, shkeljet që i atribuohen nëpunësit të proceduar nga Komisioni Disiplinor nuk janë klasifikuar drejtë.

Gjithashtu edhe në këtë ecuri disiplinore, përsërisim shkeljen e ligjit në marrjen e masës së pezullimit ndaj nëpunësit *****, marrë me aktin nr. 4430, datë 27.10.2016, të Drejtorit të Përgjithshëm, e cila e ka mbajtur nëpunësin jashtë ambienteve të institucionit, duke vështirësuar komunikimin e nëpunësit në fjalë me Komisionin Disiplinor, si dhe duke ndikuar në mbarëvajtjen e gjithë procesit në përgjithësi.

Në këto rrethana konkludojmë se vendimi përfundimtar nr. 4547/11, datë 18.11.2016, i Komisionit Disiplinor, si pasojë e tij edhe akti nr. 4547/12, datë 21.11.2016, “Për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare”, për nëpunësin *****, vijnë në kundërshtim me parimet kryesore të legjislacionit të shërbimit civil lidhur me procedurën e nxjerrjes së tij dhe bazuar në germën “a/ii”, të nenit 108, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, është akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, si dhe bazuar në nenin 110, të ligjit në fjalë, ky akt nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë duke u konsideruar sikur nuk ekziston.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; e nenin 35, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse, që për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë në këtë rast, në bashkëpunim me organet disiplinore përkatëse të drejtojnë procesin administrativ për kryerjen e veprimeve si më poshtë:
 - Të anulohet akti administrativ nr. 4430, datë 27.10.2016, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU, për dhënie mase të pezullimit nga detyra, për nëpunësin *****, dhe të rivendosen të drejtat e punonjësit për këtë periudhë, duke përfshirë edhe marrëdhënien financiare.
 - Të anulohet vendimi nr. 4547/11, datë 18.11.2016, i Komisionit Disiplinor, dhënie mase “*Largim nga shërbimi civil*” për nëpunësin *****.
 - Të anulohet urdhri nr. 4547/12, datë 21.11.2016, i Drejtorit të Përgjithshëm “*Për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare*”, për nëpunësin *****, duke e kthyer atë ne pozicionin e mëparshëm.
2. Njësia përgjegjëse, të fshijë shënimet për masën disiplinore “*largim nga shërbimi civil*”, ndaj nëpunësit *****, në dosjen e personale dhe regjistrin e personelit.
3. Të njoftohen për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike, Njësia e Personelit të Drejtorisë të Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe nëpunësi *****.
4. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative të sipërshënuara, lihet afat, **10** ditë.
5. Me kalimin e këtij afati, për përfundimin, duhet të njoftohet me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mënyrën e zbatimit të vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA